



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n./b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

**Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 01/2018**

Datë: 12.01.2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinović, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.72/2017*

2. Aktivitetet e ZRPP-së;

*Rekomandim për shfuqizim të pezullimit*

*Rekomandim për çregjistrim të 6 partive politike*

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

*Këshilli për Çështje Ligjore*

*Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale*

3. Të ndryshme

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.72/2017*

**Valdete Daka:** Së pari, më lejoni që t'ju uroj punë të mbarë në këtë vit të ri! Dhe tani, kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Në vazhdim të mbledhjes, ata miratuan edhe procesverbalin nga mbledhja nr.72/2017.

**2. Aktivitetet e ZRPP-së**

**1. Rekomandim për shfuqizim të pezullimit**

**Valdete Daka:** Urdhëro drejtoreshë!

**Miradije Mavriqi:** Zyra ka përgatitur rekomandimin për shfuqizimin e pezullimit të një partie politike, e cila ka qenë e pezulluar për arsye se nuk e ka mbajtur

tur kuvendin e saj. KQZ i kishte dhënë afat 45 ditë që ta mbajtur kuvendin. Kjo parti, e ka mbajtur kuvendin dhe zyra rekomandon për shfuqizimin e pezullimit të kësaj partie, meqë I është përmbajtur legjislacionit...!

**Valdete Daka:** Kush është për shfuqizimin e pezullimit të PSDAK-së ?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së.*

**2. Rekomandim për ç'regjistrim të 6 partive politike**

**Miradije Mavriqi:** Zyra ka përgatitur rekomandim, po ashtu për ç' regjistrim të 6 partive politike. KQZ, u kishte dhënë afat që brenda 45 ditëve këto subjekte politike t'i mbajnë kuvendet, dhe as nuk ju kan përgjigjur zyrës. Zyra, rekomandon për ç' regjistrin e tyre. Ato, kanë afat prej 24 orë, për t'u ankuar në PZAP

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të ZRPP-së (një abstenim: Ercan Spat).*

**Bajram Ljatifi:** Unë kërkoj që njoftimet t'u bëhen veq e veq, dhe po ashtu, koalicioni VAKAT të njoftohet, meqë një subjekt që po e ç' regjistrojmë ka qenë pjesë e koalicionit.

**Miradije Mavriqi:** Zyra, do t'i njoftojë me radhë...

### 3. Raport i Këshillave të KQZ-së

#### ***Këshilli për Çështje Ligjore***

##### *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale*

**Sami Hamiti:** Në mbledhjen e këshillit, kemi shqyrtuar zëvendësimet në katër komuna, dhe plotësimet janë bërë. Dhe të gjitha kërkesat për zëvendësim, i plotësojnë kushtet ligjore...

#### **Valdete Daka:**

1. Kush është për që Hajrush Shoshi, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar Agim Ademajn...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

2. Kush është për që Reshat Mujota, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën në Shtime nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit Fehmi Mujotën...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

3. Kush është për që Agim Bregaj, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit Adnan Lahun...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

4. Kush është që Basri Menxhiqi, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit Berat Asllanin...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

**Adnan Rrustemi:** A e ka dorëzuar Mirani deklaratën e pranimit, sepse nëse nuk gaboj, këta të dy janë drejtor! Është mirë me i pasë konfirmimet, dhe a është edhe deklarata e pranimit...?

**Valdete Daka:** Ata, vetë e kanë sjellë...! Le t'i shohin...

5. Kush është që Armend Rushiti, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim, duke e zëvendësuar Ajet Berishën...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

6.Kush është që Labinot Mirena, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar Fatmir Bërbatovcin...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

7.Kush është që Xhevxhet Berisha, të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Skënder Merturi. Kush është për..?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

8. Brahim Mehmetaj, emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Klinë nga subjekti politik Nisma për Kosovën, duke e zëvendësuar anëtarin Naser Morina. Kush është për..?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

9. Sabedin Hasallari, emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Han të Elezit nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin Rafet Kalisi. Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

10. Neriman Kuka, emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Han të Elezit nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin Nexhmedin Daci. Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

11. Isni Bushi, emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Han të Elezit nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtarin Menduh Vlasi. Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

12. Sabrije Krasniqi, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Han të Elezit nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, duke e zëvendësuar anëtaren Sevime Laqi. Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

Faton Shabani, emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në komunën e Vushtrrisë nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, duke e zëvendësuar anëtarin Mehmet Selacin. Kush është për..?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.*

#### **4 Të ndryshme**

**Valdete Daka:** Ju njoftojë se e kemi delegacionin e Koresë Jugore në vizitë, nga AËEB. Jemi tash e tri ditë në një vizitë bashkëpunimi. Është mirë që, meqë jemi pak më të lirë, është mirë që të bisedojmë edhe për ACEEEO, në mënyrë që ne të kërkojmë që ta organizojmë në një konferencë, dhe kjo kish me qenë

një arritje e madhe. Ndoshta, është mirë që të fillojmë qysh tash...Ne jemi anëtar, dhe qysh tash të angazhohemi...

*Pwr KQZ*

*Valdete Daka, kryetare*

-----